

**STATUTI I SHOQËRISË
“ASE” sh.p.k.**

Sot, më datë 05.09.2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë), nga Ortaku Themelues:

1. **Abdurrahman Spahiu**, i biri i Sheqyri, lindur me 17.07.1981, ne Tirane dhe banues ne Rr. “Kroit”, Nd.3, H.1 , Ap.8, Selite, Tiranë, i pajisur me letërnjoftim me nr. I10717043G.

Madhor dhe me zotësi te plote për te vepruar vendosi miratimin e këtij Statuti me terma si më poshtë:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Shoqëria Tregtare “ASE” sh.p.k. rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, indryshuar dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare, si dhe këtë statut.

Neni 1

Shoqëria gëzon të drejta si person juridik, që prej datës në të cilën kryhet regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 2

Forma e shoqërisë

Shoqëria do të ketë formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

Kjo shoqëri e këtij lloji do të përballojë humbjet e saj deri në vlerën e kapitalit themeltar të saj të paraqitur në këtë statut.

Neni 3

Emërtimi tregtar

Emri tregtar i Shoqërisë është “ASE” sh.p.k.

Neni 4

Zyra Qendrore

Zyra qendrore e shoqërisë do të jetë në adresën: **Rr. “Kroit”, Nd.3, H.1 , Ap.8, Selite, Tiranë.**

Me vendim të Asamblesë se Ortakeve kjo zyre e shoqërisë mund të ndryshohet, të hapen filiale dhe përfaqësi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.



Neni 5
Objekti i veprimitarisë

Objekti i veprimitarisë se shoqërisë do te jetë por jo të kufizohet në aktivitetet e mëposhtme:

1. Investime të të gjitha llojeve; në ndërtim, industri, energji, tregti, bujqësi etj.
2. Studime dhe projekte të të gjitha llojeve; urbanistike, arkitektonike, vepra civile, transporti, industriale, energetike të të gjitha llojeve, centrale hidraulike, centrale termike, Impante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme, nënstacione elektrikë të të gjitha llojeve dhe niveleve te tensionit, linja elektrike te të gjitha niveleve te tensionit, infrastrukture, vepra komunikacioni të të gjitha llojeve, instalime të të gjitha llojeve, vepra hidraulike të të gjitha llojeve, gjeologji inxhinierike, hidrogeologjike, të sismologjisë inxhinierike, gjeodezike, për eficencën e energjisë, mjedisore etj.
3. Ndërtime të të gjitha llojeve; gërmimi në toke, civile dhe industriale, rikonstruksione, rrugë autostrada, ura, viadukte, estakada, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudha, pista aeroportuale, punime nëntokësore, ura e vepra arti, diga të çdo lloj madhësie, tunele hidroteknike, ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e ujitje, vepra naftësjellës-gazsjellës-vajsjellës, ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë, punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime, ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike, ndërtime për nënstacionet, kabinet e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë, punime të inxhinierisë së mjedisit. Punime speciale ndërtimi: punime për prishjen e ndërtimeve, impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre, impiante ngritëse dhe transportues, punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese, impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut, sinjalistika rrugore jo ndriçuese, barriera dhe mbrojtje rrugore, ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike, struktura druri, punime strukturore special, shtresa dhe mbistruktura special, punime mbi shina dhe traversa, impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit, impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni, impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj., pastrimi i ujërave detarë, liqenorë dhe lumorë, ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij, ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane, punime topogeodezike, sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë, shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë, impiante të trajtimit të ujërave të zeza, ngritjen e laboratorëve inxhinierik.
4. Investime në fushën e energjisë.

Prodhim te energjisë duke shfrytëzuar burimet e energjisë, të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo hidrike, diellore, e erës, gjeotermale, e biomasës ose

bogazit, si dhe energjia nga mbetjet urbane. Modernizim, operimin, rritje te eficencës te impianteve te prodhimit dhe te transmetimit. Shitje dhe blerje te energjisë elektrike nga operatorë të ndryshëm privat apo shtetëror, brenda dhe jashtë vendit. Transmetim të energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin edhe transmetimin ose interkonjekcionin ndërkontinentar. Përdorim te sistemave te linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjeve transformuese e kontrolluese për transmetimin e energjisë. Operim ne sistemin e transmetimit për te kryer aktivitetin e transmetimit te energjisë dhe te dispeçerimit te energjisë, sipas kërkesave te konsumit ne nivel kombëtar. Shpërndarjen, transportin e energjisë ne sistemet shpërndarëse, duke pasur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit. Import-Eksport te pajisjeve dhe materialeve te këtij sektori.

5. Objekti i shoqërisë mund te plotësohet e modifikohet ne çdo kohe me miratimin e Asamblesë se Ortakeve/Ortakut te Vetëm ne përputhje me ligjet përkatëse .
6. Shoqëria mund të marre pjese ne shoqëri te tjera qe kane objekt te ngjashëm me të, etj.

**Neni 6
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar dhe fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

**Neni 7
Kapitali Themeltar i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakeve themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën 100.000, (njëqind mijë) Lekë, i përbërë nga në 1 (një) pjese me vlerë nominale të një pjese prej 100.000, (njëqind mijë) lekësh.

Kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë janë të ndara si më poshtë:

Nr	Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron
1	ABDURRAHMAN SPAHIU	100%	1

Kapitali themeltar është investuar nga pasuria e ortakut themelues në total. Ky kapital është i ndarë në 1 (një) pjese përkatëse. Kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve. Kuotat e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, pasi te marrin miratimin e ortakëve te tjere te shoqërisë, duke respektuar te drejtën e parablerjes, kur transferimi behet me anë te shitjes.

**Neni 8
Asambleja e Përgjithshme**

Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ne mbledhjet e tyre përkatëse. Ortakët lajmërohen me shkresë, të paktën 7 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Njoftimi duhet të përmbarajë: ditën, orën, vendin ku do të mbahet mbledhja; si dhe rendin e ditës.

Lajmërimi bëhet nga administratori ose në mungesë të tij nga një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5 % të kuotave të kapitalit themeltar nëpërmjet kërkesës me shkrim drejtuar administratorit. Ne rast se Administratori refuzon apo nuk fillon procedurën për thirrjen e Asamblesë se Ortakeve, ortaket qe kane kërkuar mbajtjen e asamblesë, mund te bëjnë vete lajmërimin e ortakeve te tjera, duke respektuar procedurat e parashikuara ne këtë nen.

Asambleja e Përgjithshme e thirrur në mënyrë të parregullt, mund te marre vendime te vlefshme, vetëm nëse te gjithë ortakët janë dakord për te marre vendime pavarësisht parregullsisë se njoftimit.

Asambleja e ortakëve duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda tre muajve nga mbyllja e periudhës ushtrimore apo sipas rasteve te parashikuara ne ligj.

Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë, apo edhe në një vend tjetër, i cili u bëhet i ditur paraprakisht ortakëve.

Në mbledhjet e Asamblesë vendimet merren me shumicën e votave te ortakeve pjesëmarrës, me përashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligjin "Për Tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

Në rast se Asambleja e Përgjithshme do të vendosë për:

- 1- Ndryshimin e statutit;
- 2- zmadhimin, apo zvogëlimin e kapitalit;
- 3- të kaluar në likuidim të parakohshëm shoqërinë, ose për të zgjatur afatin.
- 4- shpërndarjen e fitimeve.

Atëherë vendimet merren nga ortakët që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e kuotave të kapitalit themeltar.

Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me kuotat e kapitalit themeltar që ai zotëron.

Te drejtat e Asamblesë se Ortakeve do te ushtrohen nga Ortaku i vetëm për aq kohe sa shoqëria do te jete me një ortak..

Neni 9

Kompetencat e Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e vendimeve për shoqërinë ne lidhje me çështjet e mëposhtme:

- Te përcaktoje politikat tregtare te shoqërisë;
- Të vendosë për kryerjen e kontroll-revisionit finansiar të shoqërisë me ekspertë të caktuar prej tij;
- Te vendose për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- Te vendose për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- Të ushtrojë të drejta të tjera që parashikohen në ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".

Neni 10

Administrimi i shoqërisë

Shoqëria administrohet nga një administrator i zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme. Administrator i pare i shoqërisë do të jetë ortaku i vetëm i saj, **Z. Abdurrahman Spahi**.

Afati i ushtrimit të detyrës nga administratori është 5 vjet me te drejte ripërtëritje. Detyra e administratorit përfundon me mbarimin e afatit 5 vjeçar, nëpërmjet shkarkimit me vendim te ortakeve qe përfaqësojnë me tepër se gjysmën e pjesës se kapitalit themeltar, kur vete administratori jep dorëheqjen vullnetarisht. Nga momenti i mbarimit te mandatit, shkarkimit, apo dorëheqjes administratori i vjetër do vazhdoje te përfaqësoje shoqërinë deri ne emërimin e administratorit te ri, por pa patur te drejte te kryeje veprime tregtare.

Neni 11

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit

- Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua kufizon atyre apo iu jep shprehimisht ortakëve;
- Të emërojë dhe të shkarkojë nga puna punëmarrësit e shoqërisë.
- Të japë urdhra dhe udhëzime punëmarrësve dhe të vendosë sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë;
- Administratori duhet të drejtojë e të organizojë punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare;
- Te raportoje para Asamblesë se Përgjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendësi te veçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.
- Të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, të dhëna brenda kompetencave të përcaktuara nga statuti i shoqërisë dhe legjislacioni në fuqi;
- T'i paraqesë në mënyrë të rregullt Asamblesë së Përgjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancit dhe llogaritë vjetore brenda një afati prej gjashtë muajsh duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar;
- Administratori ka të drejta dhe detyrimet tona të përcaktuara nga ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare".
- Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe përfajje të kryera gjatë administrimit.
- Përfaqësimin e shoqërisë përpara organeve administrative, gjyqësore ose të tretëve, e realizon administratori personalisht ose nëpërmjet autorizimit te lëshuar nga ai. Në rast pengeshash, si sëmundje, aksidente, udhëtime etj, administratori do të autorizojë një person tjetër për përfaqësimin dhe administrimin e shoqërisë.

Neni 12

Viti Financiar

Veprimet financiare mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa mbi nxjerrjen e bilancit të formuluar konform ligjit mbi kontabilitetin.

Eshtë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme të vendosë për krijimin e fondeve nga të ardhurat neto si dhe përdorimin e tyre.

Neni 13

Mbarimi i Shoqërisë



Duke qenë se në çdo kohë për motive të ndryshme shoqëria mund të ndodhet përballë shpërbërjes, Asambleja e Përgjithshme vendos për mënyrën e likuidimit të saj, në bazë të ligjeve në fuqi.

Neni 14


Te ndryshme

Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky statut vlejnë dispozitat e ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", pjesa e pare mbi "Dispozitat e Përgjithshme", pjesa e katërt për "Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar" si dhe aktet ligjore që rregullojnë këtë veprimtari.

Statuti u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze te ligjit, një kopje për t'u dorëzuar ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe dy kopje mbeten në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Abdurrahman Spahiu

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Abdurrahman Spahiu". Below the signature is a stylized, handwritten initials "AS".